



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KPPP.nr.1021/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit “REXHA” SH.P.K, me NRB:810515223, me seli në Prishtinë, kroi i Bardhë, Llamella A, Lokali 107, kundër debitorit Komuna e Prishtinës, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Shoqëria Avokatëve “Avokatura Istrefi” Sh.P.K., me seli në Prishtinë, Rr.”Bill Clinton” H.69, kati 1, nr.1, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.44/21 të datës 12.02.2021, të Përmbartuesit Privat Mubarak S. Shamolli, me seli në Ferizaj, jashtë seancës me datë 28.12.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Komuna e Prishtinës, ANULOHET urdhri përmbartimor P.nr.44/21 të datës 12.02.2021 i Përmbartuesit Privat Mubarak S. Shamolli dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.
- II. DETYROHET kreditori që në emër të shpenzimeve të procedurës përmbartimore për përpilimin e prapësimit të ia paguaj debitorit shumën prej 208.00 € (dy qind e tetë) në afat prej 7 (shtatë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.44/21 të datës 12.02.2021, me të cilin ka lejuar përmbartimin, në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës me numër 17-220-001-52 të datës 22.12.2017, duke urdhëruar debitorin që pas pranimit të këtij urdhri t’i paguajë kreditorit tërësisht borxhin në shumën prej 46,614.90 €, me kamatë ligjore prej 8 % deri në pagesën e plotë, të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore si dhe shpenzimet për përpilimin e propozimit sipas tarifës së OAK. Ndërsa nëse debitori nuk posedon mjete monetare në llogarinë e tij bankare, përmbartuesi privat të zbatoj

përmbarimin përmes sekuestrimit të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe me shitjen e tyre të bëhet inkasimi i borxhit në llogari të kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin për përmbarim, ndër të tjerash ka deklarua që dokumenti më të cilin është lëshuar Urdhri Përmbarimor nuk paraqet dokument i përmbarues, nuk paraqet titull ekzekutiv e po ashtu nuk i plotëson kushtet esenciale siç kërkohet me dispozitat e LPP-së dhe se fatura ku është mbështetur urdhri përmbarimor është e njëanshme dhe e njëjta është nënshkruar vetëm nga ana e kreditorit. Ka shtuar se përveç të metave dhe shkeljeve esenciale të dispozitave të LPP-së fatura në bazë të cilës është lëshuar urdhri është parashkruar sipas nenit 353 të Ligjit të LMD-së. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi si i bazuar prapësimi i debitorit, të shfuqizohet Urdhri Përmbarimor P.nr.44/21 i datës 12.02.2021 i përmbaruesit privat Mubarak S. Shamolli dhe të anulohen të gjitha veprimet e ndërmarra.

Kreditori brenda afatit ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim, duke i kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit si të pabazuara duke theksuar se propozimit i ka bashkangjitur origjinalin e faturës e cila së bashku me shkresat e tjera është dorëzuar në origjinal, pra është plotësuar kushti ligjor nga neni 37 lidhur me nenin 38 të LPP-së, e njëjta i plotëson të gjitha kushtet ligjore në fuqi. Tutje ka theksuar se pretendimi lidhur me parashkrimin nuk qëndron për arsye se kontrata e cila është pjesë përbërëse e shkresave të lëndës është akoma në fuqi dhe debitori ka kërkuar punë shtesë nga ana e kreditorit gjë që afati i parashkrimit është ndërprerë nga ana e debitorit me rastin e paraqitjes së kërkesës për punë shtesë dhe për faktin se e njëjta kontratë për rregullimin e shtratit të lumit “Prishtina” e cila ka ende vlefshmëri dhe nuk është shkëputur nga ana e palëve nënshkruese të saj. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit, të mbetet në fuqi Urdhri Përmbarimor P.nr.44/2021 i datës 12.02.2021, i përmbaruesit privat Mubarak S. Shamolli, si dhe shpenzimet procedurale për përpilimin e përgjigjes në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin

e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet dhe procedura përmbartimore të përfundohet në tërësi, për shkaqet si në vijim:

Duke vlerësuar pretendimet e debitorit lidhur me afatet e parashkrimit, gjykata pas vlerësimit të faturës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 355 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 të LMD-së (Ligji Nr.04/L-077), ka ardhur në përfundim se kërkesa e kreditorit e cila rrjedhë nga Fatura nr.17-220-001-52 të datës 22.12.2017, është parashkruar.

Me dispozitën e lartcekur të nenit 355 paragrafi 1 të LMD-së përcaktohet se: *“1. Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite. Ndërsa me paragrafin 2 të nenit 355 parashihet se: 2. Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer”.*

Në rastin konkret duke llogaritur afatin e arritjes për pagesë të kërkesës për çdo dërgim të mallit, pune apo shërbimi të kryer, rezulton se kërkesa e kreditorit sipas faturës 17-220-001-52 të datës 22.12.2017, në shumën prej 46,614.90 €, është parashkruar në kuptim të nenit 355 paragrafi 2 të LMD-së, pasi propozimi i kreditorit për përmbartim është parashtruar me datë 12.02.2021, ndërsa për kërkesën e kreditorit sipas faturës së cekur më lart kanë kaluar më tepër se 3 (tre) vite nga koha e maturimit/arritjes për pagesë.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbartim, e mbi bazën e të cilit përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin, nuk ka tipare të përmbartueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbartuesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundohet në tërësi.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit të paraqitura në prapësim, mirëpo të njëjtat nuk ishin relevante për këtë çështje përmbartimore.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës përmbartimore, gjykata ka vendosur në kuptim të dispozitave të nenit 463 dhe 453 par.2 të LPK-së, lidhur me nenin 17 dhe 13 të LPP-së, duke ia njohur shpenzimet e të autorizuarit të debitorit për përpilimin e prapësimit në shumën prej 208.00 €, siç është e përcaktuar me rregulloren në fuqi për tarifatat e avokatëve, të datës 18.03.2017 të Odës së Avokatëve të Kosovës.

Gjykata në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1021/22, datë 28.12.2023

Gjyqtari

Gent Bekeri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimin të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.